

**PËR KONTRIBUTIN E GJUHËSISË SHQIPTARE  
NË STUDIMET ETIMOLOGJIKE TË SHQIPES**

*Idriz Ajeti*

Instituti Albanologjik  
i Prishtinës

KUD 809.198.3—3  
Punim studimor

Marrë për botim më 27. X. 1989

**Përmbajtja e shkurtër:** Në këtë punim pasqyrohet zhvillimi i gjuhësisë shqiptare duke filluar me Fran Bardhin, Konstantin Kristoforidhin, S. Frashërin, De Radën, Dh. Kamardën etj., veprat e të cilëve hedhin themelet e gjuhësisë shqiptare.

Zhvillimi i gjuhësisë shqiptare, në vështrim të gjerë, duhet projektuar në dy fusha të kundërta vepruese: në njërin anë qëndron ajo vendëse — gjuhësia shqiptare me tradita treqindvjeçare në burimet e së cilës është fjalori latinisht-shqip i zadrimorit Fran Bardhit. Puna në fushën e kësaj gjuhësie nis të gjallërohet në periudhat e mëpastajme, dua të them nga gjysma e dytë e shekullit XIX, me Konstandin Kristoforidhin, S. Frashërin, De Radën, Dh. Kamarden etj., veprat e të cilëve hedhin themelet e gjuhësisë shqiptare.

Shtylla kryesore padyshim është Konstandin Kristoforidhi — njëra nga figurat më të plota të veprimtarëve të Rilindjes. Ishte studiues i gjuhës shqipe dhe njohës më i miri dhe më i thellë i saj në kohën e vet. Në fjalorin e tij të gjuhës shqipe të shpjeguar me greqishten e re (i botuar pas vdekjes së autorit, në Athinë më 1904) fjalët e përfshira në të i shqyrtoi dhe i shoshiti edhe nga aspekti historik a nga pikëpamja etimologjike. Një kapitull të vogël të këtij fjalori e përbëjnë huazimet sllave të gjuhës shqipe. Në vështrimin e tij për fjalorin e Kristoforidhit, veçanërisht për interpretimet e tij etimologjike, Prof. Çabej thotë se etimologjitë e Kristoforidhit në një pjesë të mirë janë të pakontestueshme.

Duke përkrahur tezën e origjinës pellazge të gjuhës shqipe, një numër i madh i romantikëve, dua të them i rilindësve shqiptarë mbronin tezën e përhapur në shekullin XIX se shqiptarët janë pasardhës të pellazgëve.

Një rrugë që emra të lashtë në trevat në të cilat banonin popullsi Ilire të shpjegohen me mjete të shqipes, kishte zënë të rrihte vetë babai i albanologjisë, George Von Hahni, një mendim që edhe sot e gjithë ditën gjen përkrahjen dhe pranimin e disa albanologëve. Mendimin e Hahnit e përqaftuan, ta përsëritim, gati të gjithë rilindësit dhe romantikët shqiptarë.

Njohja e historisë së gjuhës, e etimologjisë shkencore, u mungonte atyre, pothuajse krejtësisht. Jemi te stadi i gjuhësisë parashkencore ndër shqiptarët. „Duke përjashtuar ndonjë vepër si atë të dijetarit arbëresh, Dhimitër Kamarda, të shekullit të shkuar, etimologjia e shqipes, e punuar prej autorëve vendës në të kaluarën, ka qenë punë diletantësh, megjithëse duhet thënë se jo rrallëherë me rrugë intuitive ka goditur në shenjë” (E. Çabej, studime filologjike, 1980/1 fq. 59).

Bashkëqytetar i Kristoforidhit dhe vazhdues i veprës së tij të madhe në fushën e gjuhësisë shqiptare dhe pasues i ideve dhe i veprimeve më të përparuara për gjuhën letrare shqipe, që në të zënë të shekullit tonë, ishte A. Xhuvani. Në fillim të shekullit tonë zuri të studiojë filologjinë greke në universitetin e Athinës, në një kohë kur gjuhësia historike krahasuese kishte arritur shkallën më të lartë të zhvillimit të saj. Në këtë kohë për gjuhën shqipe dhe zhvillimin e saj historik ishin shprehur autoritetet e njohura të gjuhësisë indoevropiane, Bopp, Brugmann, Mikloshiq, G. Myeer, Holger Pedersen, etj. Që atëherë Xhuvani merr dhe interesohet, i entuziazmuar, për vlerat e veçoritë e shumta origjinale të gjuhës shqipe dhe nuk do të pushojë së interesuari për të gjitha degëzimet e gjuhës shqipe deri në çastet e fundit (1961).

Xhuvani ishte i vetëdijshëm për vështirësitë dhe përgjegjësinë e madhe të studimeve etimologjike për të cilën punë shprehej: „Duhet me u ditë që më parë ligjet fonetike si të gjuhës fjalëve të së cilës përpiqemi t'ua gjejmë rrânjët si dhe të gjuhëve motra. Por, veç fonetikës duhet me u ditë edhe semantika e semasiologjia e fjalëve” (Studime gjuhësore, Tiranë, 1956, fq. 58). Në një vend tjetër në lidhje me gjurmimet etimologjike Xhuvani thekson: „Ai që mirret me etimologji të shqipes duhet me qenë i regjun edhe në linguistikë: pa njohuritë e duhuna mbi këtë shkencë nuk mund të bajmë tjetër veçse një punë diletanti pa themel e pa randësi fare”.

E thamë edhe më lartë që A. Xhuvani ishte studiues i pasionuar i të gjitha degëve të gjuhës shqipe: shumë herë e ngashnjenin edhe gjurmimet etimologjike të gjuhës shqipe, porse, sikundër thoshte me të drejtë Çabej duke u shprehur për formimin e Xhuvanit në punë të studimeve krahasuese indoevropiane dhe të etimologjisë shkencore: „Me Aleksandër Xhuvanin mund të themi se nis etimologjia shkencore e gjuhës shqipe, e lëvruar prej vetë shqiptarëve”; me fjalë të tjera Çabej do të thoshte se këto studi-

me të etimologjisë shkencore ndër shqiptarë posa kishin dalë nga rrethi studimor diletant me mungesa të mëdha. Edhe Jokli, pasi kishte lexuar disa shkrime të tij, në një letër që ia niste profesor Xhuvanit, shkruante: „Selectet Tuaja i nderuari zotni profesor, unë jam duke shqyrtua pikërisht tani më së afërmi (së bashku me artikujt e tjerë të „Kopshti letrar”). Po edhe në qoftë se unë nuk jam dakord me gjithë derivimet Tuaja, prapëseprapë dua të vë në dukje që puna Juaj është jashtëzakonisht e vlefshme dhe e meritueshme, qoftë edhe për shkak të pasurimit të njohurive tona mbi fondin leksikor të shqipes”. Për hir të së vërtetës do thënë se Xhuvani në punë të etimologjisë shkencore zotëronte më së miri fondin leksikor të të gjitha dialekteve dhe të të folmeve shqiptare përhapjen e tyre gjeografike me gjithë larminë e trajtave të tyre — premisë për çfarëdo filli të drejtë në zbërthim etimologjik. Në anën tjetër, Xhuvani as në fakultetin e Athinës, si student, nuk kishte marrë formim të atillë linguistik që do ta kualifikonte për operatione sa më të drejta etimologjike. Shumë letra nga lehtëkëmbimji i Xhuvanit me Joklin, në të cilat ai i lutej Joklit ta njoftonte për gurrën e ndonjë fjale a shprehjeje të shqipes, flasin qartë për formimin e mangët të Xhuvanit në gjuhësinë krahasuese indoevropiane.

Në trashëgiminë kulturore shqiptare që nga shekulli XVI e të-hu, arbëreshët e Italisë kanë lënë gjurmë të thella duke vënë në ndërtesën e saj disa gurë të fortë e të qëndrueshëm. Në lëvizjen mendore të asaj popullsie shqiptare, pasi ishte stabilizuar në pikëpamje materiale në atdheun e ri, sidomos në qindvjetëshin XIX, me synime të ringjalljes kulturore të atyre ngulimeve arbëreshe, ka dy burra të shquar me Dhimitër Kamardën dhe Mark La Pianën në krye, që zënë një vend me rëndësi në fushën e studimeve gjuhësore. Është po e njohur vepra e Kamardës — Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese, Livorno, 1864, dy vjet më vonë del në Prato të Italisë bleu i dytë i kësaj vepre: Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese.

Në veprën e parë të tij, Kamarda ndjek pikëpamjet e një brezi më të vjetër mbi afritë e shqipes me grupin „pellazgjik”, me greqishten e latinishten. „Kamardën e shquan, thotë Çabej, një talent i rrallë, por e ka dëmtuar mungesa e dallimit shkencor të elementit vendës të leksikut nga elementi i huaj”.

Kur do të gjykohet mbi vlerën e përgjithshme të Marko La Pianës, pas mendimit tonë, Çabej ka plot të drejtë kur thotë se puna e këtij dijetari del shumë më komplekse për arsye se disa punime me vlerë të sigurt kanë mbetur dorëshkrim e që presin t’u shkundet pluhuri e të shohin dritën e botimit, siç janë një gramatikë historike krahasuese dhe një fjalor etimologjik i gjuhës shqipe. La Piana që më 1912 qiti në dritë i pari shkrimin më të vjetër të arbërishtes — veprën e Lekë Matrangës të vitit 1592, të

botuar në të përkohshmen „Roma l'oriente”. Duke mos u ndarë nga studimet e shqipes, të historisë së saj dhe të lidhjeve me gjuhët e tjera, La Piana botoi më 1937 një studim të hapët mbi zanoren o të gjatë në elementet vendëse dhe latine të shqipes; pasojnë veprat e tjera; Studi linguistici albanesi I (1937), II (1949); Sul rieccheggiamento delle liquide e delle nasali nell'albanese (Roma 1952).

Linguisti arbëresh La Piana është marrë me çështje gjuhësore nga pikëpamja historike një jetë të tërë njeriu. Veprat e tij të jetës — Gramatika krahasuese e gjuhës shqipe dhe fjalori etimologjik i saj, që të dyja dorëshkrim, pasqyrojnë dëshmime e prova të sigurt të autorit për përpjekje të ngulët e të patundur në punë të shoshitjes sa më të plotë të visarit leksikor të gjuhës shqipe, të zbërthimit e të sqarimit historik të një morie çështjesh morfologjike të saj.

Pas viteve të tridhjeta në studimet historike në fushë të shqipes del Eqrem Çabej, një linguist i ri i formuar në qendrën universitare të Vjenës. Duke përfituar nga kushtet e rrethanat e volitshme në atë qendër të njohur universitare me një qerthull të fortë kërkimor, Çabej njohu dhe thithi kulturën e arritjet e linguistikës së kohës me rryma e lëvizje që sundonin në atë fushë studimesh duke i përvetësuar ato në mënyrë të shkëlqyer. Prandaj, vetëm me Çabejn nisnin studimet etimologjike të mirëfillta shkencore të gjuhës shqipe, të lëvruara prej vetë shqiptarëve.

Pas zhdukjes tragjike të Joklit, njohësitë më të mirë të çështjeve gjuhësore në fushë të shqipes, gatitjet e një fjalori etimologjik të shqipes, u tretën si kripa në ujë dhe vetëm Çabej mund ta rimerrte një punë të tillë dhe me dorë të sigurt ta përfundonte fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe pas atij të Meyerit.

Çabej vite me radhë në mënyrë sistematike përgatiti terrenin, duke i bërë edhe parapërgatitjet e domosdoshme për fillimin e punës në hartimin e fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe. Përfitoi nga rrethana se me vite kishte qëndruar në Romë, ku i papenguar mundi të gjurmonte dokumentet e rralla që vetëm në arkivat e qytetit të lashtë të Romës mund të gjendeshin, si ky i „Mesharit” të Gjon Buzukut (1555). Ai këtë libër e studioi sistematikisht duke bërë transliterimin dhe transkriptimin në mënyrë që të shërbejë si model se si duhet të veprohet në punë tekstologjike. Duke u njohur edhe me veprat e tjera të letërsisë së vjetër shqipe si të Budit, Bardhit, Bogdanit, Kazazit dhe me literaturën arbëreshe, Çabej pasuroi shumëfish skedarin e fondit leksikor me fjalë të panjohura deri atëherë. Shfrytëzoi edhe rrethanat e tjera të volitshme si numrin e shtuar të të folmeve të trajtuara, pasurimin e letërsisë së shkruar në gjuhën shqipe me veprat e reja e krahas kësaj edhe inventarin leksikor.

Që nga numri i katërt i revistës shkencore Buletin i Universitetit shtetëror dhe Studime filologjike, Çabej zuri të botojë një version seleksionues të fjalorit etimologjik në të cilin përpunoi afro një mijë njësi leksikore; në vitin 1976, në botim të Akademisë, doli në dritë vëllimi i II i fjalorit të tij etimologjik (Studime etimologjike në fushë të shqipes). Në këtë vëllim Çabej trajtoi dy shkronja (A—B) të alfabetit të shqipes me afro një mijë fjalë.

Në vëllimin III të Studimeve etimologjike në fushë të shqipes, Tiranë 1987, c-ç-d, Çabej ka shoshitur më se një mijë fjalë nga pikëpamja etimologjike. Një gjë që i bie në sy çdo vëzhguesi a lexuesi të kësaj vepre, është kjo që zberthimi i çdo lekseme të shqipes paraqet një studim të thukët në vete, një vijë metodologjike specifike që nuk ndeshet kund në punë të shoshitjes etimologjike të fondit leksikor sot. Shtigjet që Çabej i ka rrahur në përpunimin e fjalësit në dy vëllimet e posazëna ngojë këtu sipër, janë një rrugë që ndjek zhvillimin e fjalëve në fillin e tyre historik me qëllim që të dokumentohet shfaqja e parë e fjalës dhe vështrimi i saj kuptimor.

Në veprën madhore të tij — Studime etimologjike në fushë të shqipes, Çabej si në dy vëllimet e kryera, ashtu edhe në të tjerat të projektuara — në të parën (1982) kishte ravizuar rrugët që do t'i rrihte në përpunimin e fjalësit në shoshitje pasi kishte bërë në mënyrë të gjithanshme e kritike analizën e punës së kryer në fushën e studimeve etimologjike të studiuesve të mëparshëm, me argumente dhe bindshëm kundërshtoi një varg zgjidhjesh të etimologëve të mëparshëm, të mangëta, qoftë për shkaqe të objektivitetit, qoftë për shkaqe të mosnjohjes së mjaftueshme të gjuhës shqipe, qoftë, më në fund, për shkak të mangësive metodologjike a të parimeve mbi të cilat mbështeste teorinë e vet gjuhësore. Kuptimi i gjerë që autori i jep disiplinës etimologjike, e cila nuk merret vetëm me kërkimin e prejardhjes së fjalëve, por përcjell gjithë jetën e tyre, mjedisin ku u krijuan ato, shtrirjen e tyre gjeografike brenda territorit gjuhësor të shqipes dhe jashtë tij, aftësinë e tyre për krijimin e fjalëve të reja, shkathtësinë që të hyjnë në përbërjen e fjalëve të tjera, — e gjithë kjo i jep kësaj vepre të rrallë të kulturës shqipe rëndësi të shumëfishtë për kërkime të shumëllojshme në fushën e problematikës gjuhësore të shqipes në planin diakronik e sinkronik.

Në hyrjen e kësaj vepre të vëllimshme mbi studimet etimologjike të shqipes si edhe në punimet e mëhershme të tij, Çabejn dhe shumë studiues të leksikut historik të shqipes e intereson raporti i pjesës së huazuar me të pjesës burimore të fondit leksikor të shqipes. Nga një statistikë e përafërt që kishte bërë linguisti Eqrem Çabej dilte se elementi autokton burimor i visarit leksikor të shqipes është më i madh në raport me pjesën e saj të huazuar kur pasqyron format primitive (të pazhvilluara) të jetës,

shkallën e ulët të ekonomizimit blegtoro-agrar dhe atë kulturor, ndërsa mbizotërues është fondi i shprehjeve të huazuara në ato pjesë të fjalorit që lidhet me një jetë materiale e morale më të zhvilluar. Në emërtimet e konfiguracionit të terrenit, thotë Çabej, në emrat e botës bimore, të dukurive atmosferike, në emërtimet e produkteve bujqësore në prodhimet e qumështit, në emërtimet e trupit të njeriut dhe të funksioneve të tij, — në të gjitha sferat e përmendura mundësitë shprehëse të trashëgimisë indoevropiane janë më të mëdha në raport me ato të huazuarat: në tërësinë leksikore prej afro 564 fjalësh, raporti është 342 me burim vendi ndaj 222 huazimeve. Krejt ndryshe nga ky përpjesëtim, në disa sfera të tjera elementi i huaj që ka hyrë në gjuhën shqipe në rrjedhën e zhvillimit të saj, tejkalon elementin e vendit.

Siç shihet nga kjo pasqyrë e cila, ta themi, mund të jetë vetëm e përkohëshme, kurrësi përfundimtare, në tërësinë e gjithmbarshme leksikore të gjuhës shqipe, sikundër na është e njohur, pjesa e saj e cila në një periudhë të gjatë kohore ka hyrë në të, mbizotëron mbi pasurinë leksikore të vendit, edhe se në gjendjen e sotme të shkencës, siç u theksua, në raportin midis këtyre dy përpjesëtimeve të leksikut të shqipes, nuk mund të bëhet kurrfarë bilanci përfundimtar.

Në lidhje me këtë pasqyrë statistikore vetëm edhe një e dhënë që pas mendimit tonë do të ishte drejtimdhënëse dhe mbështetëse e çfarë për t'i kuptuar rrugët që ka rrahur Çabej në punë të shoshitjes së leksikut historik të shqipes. Sikundër dihet, Gustav Mayeri në Fjalorin e tij etimologjik të gjuhës shqipe (1891), kishte arritur të përpunonte gjithsejt 5410; nga ky numër leksemash të shoshitura nga pikëpamja etimologjike ky studiues sistematik një sasi leksemash u shihte karakterin indoevropian të trashëguar e 700 të tjera i la pa shpjegim duke mos ia dalë të përcaktojë prejardhjen e tyre.

Të përsërisim parimin kryesor të zbatuar nga Çabej — një metodë pune e tij të ndjekur në gjithë rrjedhën e shoshitjes së leksikut të shqipes: „mbështetja te një lëndë gjuhësore të pasur e të pashfrytëzuar më parë, njohja e thelluar e fakteve gjuhësore zbatimi i një metode të rreptë shkencore të ndjekur sistematikisht duke vepruar së pari me krahasime të brendshme e duke kaluar në përqasje të jashtme në rrafshin ballkanik dhe indoevropian vetëm pasi të jenë sqaruar lidhjet brenda shqipes, i kanë dhënë autorit mundësi të arrijë në rezultate të rëndësishme me zgjidhje të reja, në etimologji më të drejta, më të sakta.

— Jo pak fjalë të shqipes, të analizuarat prej albanologësh — të lehtë në punë të njohurive albanologjike, kanë qenë shpjeguar gabim nga ana e burimit, pikërisht për arsye se kanë qenë të trajtuar shkëputur, jo përbrenda lidhjes së brendshme që kanë me fjalë të gjuhës; bie fjala: besë shkon me *bé*, *bërthamë* me *bathtë*,

e jo me greq. *στήλη* „shtyllë”, *bërryl* me *ber* „hark”; *bloshkë* „bujashkë, ashkël” shkon, sikundër i del Çabejt, me *bluaj* e jo me isl. e vj. bloesc „squama”, *bohët* „ndiqet” (për disa shtazë shtëpiake) me *dëboj* e jo me *bie*, e *mëbaj* e as me grupin e lat. venor „gjuaj”; *cucë* me *cull* e jo me magj. *Cuca* „dashnor”, çuk, „prek, provoj, shtie kalla” me çokas, çukth, qok, quk etj. e jo me bulg. çukam; *danë*, *dana*, *darë* me *daj* e jo me greq. dakmo, dhakmo, „kafshojë”; darsmë, dasmë, me darkë e jo me greq. γαμος; *dështoj* me shtie shtoj e jo me një lat. depozitare, as me it. tosto „shpejt” (p tosto); *dhelatoj* me *ledhe* „përkëdhelje” e jo me it. diletto, skr. delet „epsh”; *epem* „përkulem, lakohem” — ap e jo me greq. σταμβος „i përkulur”- *ergjës* „morrat e vegjël që sapo kanë dalë nga thëriat” me sinonimin *argull*, *argës* e jo me arm. orjil „morr”; hulli. holli „vijat që çon parmenda në arë, brazdë” me hulloj, holloj jo me lat. sulcus „hulli”; *kij*, *kizë* me *kadhë*, *kadhën* e jo me lat. incidere „gdhend”; *lajka* me *larë* e jo sllav. e vj. laskat; *laroj* „lajkatoj” (në Jabllanicë, në Serbi Jugore m’u laritë, lariçkë) po me *larë* e jo me këtë folje të sllavishtes — *laskati*; *lajthi* me *lak*, *lakth* e jo me sllav. „leska „lajthi” — ose me lit. *lazda* „shkop, lajthi” (Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, Tiranë, 1982, fq. 77).

Çabei zbatoi metodën intensive të studimit të çështjeve gjuhësore duke ecur në vazhden e mësuesve të tij të mëdhenj, para së gjithash ravën e Norbert Joklit — mësuesit të drejtpërdrejtë të tij. Në punët e shoshitjes se etimologjive të gjuhës së tij amtare, Çabej asnjëherë nuk qëndroi i patundur në mendimin e vet kur argumentet nuk flisnin për burim vendi të një fjale, e kur mungonin të dhëna të vërtetuara për një brumë të huaj të saj, ajo atëherë lihej pa shpjegim, kështu që fundja është parim i drejtë.

Studimet etimologjike të Çabejt, përveç rëndësisë së madhe të historisë së gjuhës shqipe, njësimi dhe stabilizimi të formës letrare të saj, për historinë e popullit kanë peshë të veçantë, sepse në një gjendje të heshtjes së shkrimeve historike të saj lokalizmi i vendit të formimit të tij merr një rëndësi të dorës së parë me faktin që zhvillimi nga format e para në të sotmet i një numri toponimesh gjen shpjegimin te ligjet e fonetikës historike të gjuhës shqipe.

Në cerekshekullin e fundit kryesisht pranë fakultetit të filozofisë dhe të institucioneve të tjera shkencore të Prishtinës, është krijuar një bërthamë e vogël shkencore, e cila ka arritur rezultate të dukshme në fushën e shkencave albanologjike. Me meritën e individëve në hulumtimin e shumë çështjeve nga fonetika historike dhe gramatika e gjuhës shqipe, duke zbatuar metodat shkencore të kohës, janë korrur rezultate të dalluara. Metoda tradicionale shkencore gradualisht por sigurt shkoi e u zëvendësua me metoda të reja shkencore, me të cilat shkenca mbi gjuhën u përterit dhe u përparua (Bokshi, Ismajli).

Në bërthamën e përmendur shkencore disa punonjës albanologë të moshuar e të rinj, kanë zënë të merren edhe me shohitjen e visarit leksikor nga pikëpamja etimologjike. Sikundër dihet punime që të rroknin pjesën leksikore të gjuhës shqipe, të shkuar në gjuhë të tjera fqinje, ka fare pak edhe ato janë fragmentare e të rralla. „Në lidhje me këtë nuk mund të mos thuhet që ka pasur e ka, mbase, edhe sot një prirje të ngritur vise-vise në një traditë që të mos gjykohet ndikimi shqiptar mbi gjuhët fqinje në përmasat e drejta” (Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, I 1982, 132).

I. Popović, një studiues i ri nga shkolla sllavistike e Universitetit të Beogradit, me hapa të guximshëm la pas traditën këtu sipër të përmendur, duke thyer paragjykimet se serbokroatishtja s'është e trazuar me elemente leksikore, të hyra së jashtmi, përkundrazi, ai tregoi se të folmet serbe e maqedone, kanë në inventarin e tyre një leksik të konsiderueshëm, të shkuar atje nga gjuhë të tjera, edhe prej idiomave shqiptare (Albano-slavica, Südostforschungen, 1956, XV; Geschichte der Serbokroatischen Sprache, Wiesbaden, 1960).

Mbi dëshminë e studimeve të kryera në kohë të fundit edhe në qerthullin e përmendur shkencor të Prishtinës, në të folmet e sllavëve të jugut, sidomos në idiomat serbokroate e maqedone, është konstatuar një leksik i gurrës shqipe në një masë shumë më të madhe seç mendohej. Nga ana historike, burimi shqiptar i shumë termave nga sfera e blegtorisë përlligjet lehtë, ngase ajo ishte mjeshhtëria nacionale e shqiptarëve, barinjtë e të cilëve, duke shtetuar vend më vend, përhapnin fjalë-terma nga fusha e blegtorisë në vise të tjera të Ballkanit, bie fjala: *vatra, katun, balega, frus, hira, štrunga, šulina, bardoka, balja, balješka, ljareza, djama* e shumë të tjera.

I ndjeri Ivan Popović, një studiues i zellshëm i studimeve shqiptare-sllave thoshte se numri leksikor i shqipes në të folmet serbe, maqedone, mund të kapë njëmijëshin.

Në Fjalorin e gjuhës popullore e letrare të serbokroatishtes, që hartohet në Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, gjejmë foljen: *zaprúšiti, zàprūšim*, një krahinarizëm që del me këto kuptime „Këllas, shtie në dhe, mbuloj, mbush me dhe, me zall, me rërë”. Kur është fjala për burimin e foljes sonë në vështrim, ne nuk arrijmë atë me çfarëdo fjale tjetër të serbokroatishtes që të ketë një kuptim të afërt me fjalën tonë në studim; njëfarë afërie fonetike dhe kuptimore gjejmë te shprehja *zaprashiti* e serbishtes, e dalë nga *prah* „pluhur”. Mbi mbështetjen e shpjegimit të sipërm fonetik e vështrimor, foljen e të folmeve serbe *zaprúšiti* e shohim të ardhura nga shqipja „prush”.

Po në këtë Fjalor ndeshim një folje tjetër gurra e së cilës ka mbetur e diskutueshme; është fjala për foljen *zašatiti*, *zašatim* me përhapje të kufizuar e krahinore, te *Užica*, në Serbinë Perëndimore që del me një vatër të gjerë vështrimore: „kap, marr, nxjerr, rrëmbej, përfshij, rrok një sasi ujë ose diçka tjetër”. Po të duam të ndjekim etimologjinë e kësaj fjale, si çdo herë edhe këtu pikësepári ajo do të zbërthehet në elementet e saj përbërëse. Në rastin konkret tema e kësaj foljeje do të jetë pa farë dyshimi e shqipes — *shat*, me formantin — *za* dhe mbaresën infinitivale sllave — *ti*, pra *za + shat + ti = zašatiti*, me kuptim: „marr, rrok me shat dhe”.

Nga po ky Fjalor i Akademisë Serbe të Shkencave kishim nxjerrë fjalën *djelak* „djalosh, djalë i rritur 14—16 vjeç”. Mbi dëshminë e fakteve e në mbështetje të njohurive tona mbi të folmet serbe të këtyre anëve, nuk e dimë të ketë kund më ndonjë prej gjuhëve të sllavëve të jugut fjalë me trajtë, që të përkonte me këtë tonën, si nga pikëpamja fonetike, si nga ajo vështrimore. Për mendimin tonë, nuk mund të quhet kontribut në shpjegimin e saj as gjykimi i Momčilo Savićit i shfaqur te *Južnoslovenski filolog XXX*, 1—2, që shprehjen *djelak* e bie të ardhur nga një turqizëm me burim arab — *dželat* — *xhelat* „ai që zbaton publikisht dënimin me vdekje të një njeriu duke i prerë kokën, fig. njeri pa mëshirë, mizor”, sepse ai sidomos nga pikëpamja e kuptimit kurrsesi nuk afrohet me fjalën tonë në studim.

Në historinë e kësaj fjale *đelak* duke hapur një shteg tjetër, na mban shpresa se do t'i jepet zgjidhje e kënaqshme kësaj çështjeje. Përballë gjeografisë dialektore, nuk është vështirë të mendohet një shprehje e të folmeve shqiptare përreth Burimit të Moravës — *djalë* — në këto anë *gjal*, shm. *gjel* që të jetë shtrirë njëherë si term në gjuhë të fshehta serbe të këtyre anëve e me kohë të ketë shkuar edhe në gjuhën e përditshme të popullsisë serbe të këtyre anëve.

Në të folmet malazeze është shënuar e Fjalori i Akademisë Serbe e regjistron foljen — *zarepati se*, *zàrēpām* „premtoj, jap fjalën, zotohem”, zgjedhimi mesor — *zarepati se* „zotohem, rrëfhem”. Edhe se nuk do të pritej, kjo folje gjen shpjegimin e vet vetëm përbrenda shqipes, te folja e sferës fetare — „rrëfhem” që me kohë është shtrirë edhe te sfera të tjera. Në fjalën tonë në shqyrtim janë kryer disa ndryshime fonetike; është fjala për ndërrimin e *f > p*, një dukuri fonetike relativisht e vjetër në të gjitha gjuhët sllave: *foccacia > pogača*, gr. *trafos > trap*; nga e shqipes *fara > maq. pora* „brez, gjeneratë, Makedonski jazik II (1951), 92.

Në bërthamën tash sa herë të përmendur ka dalë një brez i ri shkencor me punimet e të cilëve nga fusha e gjurmimeve të leksikut historik të shqipes, pikërisht në lëmin e kërkimeve etimologjike, janë gjallëruar studimet etimologjike shqiptare-sllave, që është një indic i mirë se ato studime, të lëna mënjanë do të marrin të mbarën.